



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES
SEKTORI I MENAXHIMIT TË E-KËRKESAVE DHE E-ANKESAVE

Nr. 9563 prot.

Vlorë, më 15.05.2026

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

DATË 13.05.2026 ORA 11:00

Tema: Konsultim publik për miratimin e fashës së orare të hedhjes së mbetjeve nga qytetarë dhe bizneset në territorin e Bashkisë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë.

Marrin pjesë:

Nënkryetar i Këshillit Bashkiak Vlorë-z. Novruz Rrokaj, Nënkryetare e Bashkisë – znj. Irena Toshkallari, Kryetarët e Rajonove, Drejtore e Ndërmarrjes së Pastrimit – znj. Anjeza Shiko, Kryetare e Këshillit Bashkiak – znj. Launela Dautaj, Anëtar të Këshillit Bashkiak, drejtorë të Administratës së bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.

Takimin e hapi Nënkryetari i Këshillit Bashkiak Vlorë-z. Novruz Rrokaj: Përshëndetje të gjithëve, ju falënderojmë për pjesëmarrjen në këtë takim, i cili organizohet mbi fashat e orareve për menaxhimin e mbetjeve nga familjarët dhe bizneset. Tani i jap fjalën drejtoreshës së Ndërmarrjes së Pastrimit, për të sqaruar më në detaje projektin që kemi sjellë. Mendimet, sugjerimet dhe diskutimet tuaja janë shumë të rëndësishme për ne dhe do të na ndihmojnë në përmirësimin e këtij projekti.

Drejtores e Ndërmarrjes së Pastrimit – znj. Anjeza Shiko: Përshëndetje të gjithëve, Sikurse jeni vënë në dijeni, Bashkia Vlorë, më datë 16 prill, ka afishuar njoftimin publik në lidhje me dëgjuesën për vendosjen e fashave orare për hedhjen e mbetjeve urbane nga qytetarët

dhe bizneset. Ndërmarrja e Pastrimit propozon dy kategori fashash orare, si për sezonin turistik ashtu edhe jashtë sezonit. Oraret e hedhjes së mbetjeve urbane gjatë periudhës së sezonit turistik, do të jenë si më poshtë:

- Për qytetarët orari i hedhjes së mbetjeve do të jenë fashat orare:

ora 06:00 deri në orën 10:00

ora 19:00 deri në orën 23:00.

- Për subjektet fizik dhe juridik, orari i hedhjes së mbetjeve do të jenë fashat orare:

ora 15:00 deri në orën 16:30

ora 23:00 deri në orën 03:00.

Oraret e hedhjes së mbetjeve urbane jashtë sezonit turistik, do të jenë si më poshtë:

- Për familjarët orari i hedhjes së mbetjeve do të jetë në fashën:

ora 06:00 deri në orën 10:00

ora 19:00 deri në orën 22:00.

- Për subjektet fizik dhe juridik, orari i hedhjes së mbetjeve do të jetë në fashën, si më poshtë:

ora 06:00 deri në orën 09:00

ora 21:00 deri në orën 23:00.

Gjithashtu, presim mendimet dhe sugjerimet tuaja për një qytet më të pastër dhe më të jetueshëm.

Z. Flamur Habilaj, Rajoni 1, zona përreth spitalit: Kërkojmë heqjen e barishteve që dalin anës rrugëve, pasi dëmtojnë pamjen e qytetit; largimin e ujit nga rrugët; vendosjen e më shumë koshave të mbeturinave, si dhe vendosjen e mureve mbrojtëse pranë tyre për të evituar përhapjen e mbetjeve. Të jenë më të shpeshta qarkullimet e mjeteve për heqjen e mbetjeve.

Drejtores e Ndërmarrjes së Pastrimit – znj. Anjeza Shiko: Aktualisht janë vetëm dy frekuenca të qarkullimit të mjeteve.

Nënkryetare e Bashkisë – znj. Irena Toshkallari: Për pjesën e rrethimit të koshave, është parashikuar në këtë zonë?

Drejtores e Ndërmarrjes së Pastrimit – znj. Anjeza Shiko: Rrethimi i kontenierëve ka filluar në qytet, në rrugët kryesore dhe në zonat ku janë kryer investime. Patjetër, ky proces do të shtrihet edhe në blloqet e banimit dhe në periferi të qytetit.

Anëtar i Këshillit Bashkiak - z. Gjergj Nika: Përshëndetje,

Përpara se të vijmë te fashat orare, duhet të mendojmë për pikat e mbeturinave në pjesë të ndryshme të qytetit, pasi ka shumë pika të vendosura në mes të qytetit, në mes të rrugës apo anës trotuareve, të cilat janë vende të papërshtatshme. Ato që ndodhen në zona shumë të dukshme duhet të zhvendosen pas pallateve, pasi kthehen në një katastrofë estetike dhe higjienike. Për sa i përket fashave orareve, në ndihmë të qytetarëve për ta kuptuar më mirë, informacioni duhet të afishohet edhe në monitorë informues. Gjithashtu, duhet të përcaktohen dhe oraret e pastrimit. Sipas mendimit tim, fashat e orareve aktuale janë të papërshtatshme, sidomos për pjesën e biznesit. Mendoj që fasha e orareve për bizneset duhet të jetë gjatë natës deri në mëngjes, ndërsa pastrimi të kryhet në orët e para të mëngjesit. Gjatë ditës nuk duhet të

ketë hedhje mbetjesh nga bizneset. Gjithashtu, duhet të përcaktohen qartë edhe fashat e orareve të pastrimit.

Qytetare: Ju përgëzojmë për nismën që keni marrë për vendosjen e dy orareve për hedhjen e mbeturinave. Nëse vendoset që mjetet e pastrimit të kalojnë pranë bizneseve për heqjen e mbetjeve, do të ishte edhe më mirë. Mendojmë gjithashtu për vendosjen e disa qeseve të përshtatshme për hedhjen e mbeturinave, si dhe që koshat të jenë të mbyllur. Çdo qytetar duhet të edukohet për ndarjen dhe hedhjen e mbetjeve sipaskategorive përkatëse.

Gjithashtu, edhe kundrejt një pagese, mund të vendosen kamionçina më të mëdha për bizneset e mëdha, për heqjen e mbetjeve pranë aktivitetit të tyre.

Drejtoresha e Ndërmarrjes së Pastrimit – znj. Anjeza Shiko: Bashkia po merret me hartimin e Rregullores për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, e cila është një detyrim ligjor dhe kërkon që bashkia të përmbushë të gjitha kriteret e përcaktuara nga ligji. Në vitin 2023 është miratuar Plani Strategjik për Menaxhimin e Mbetjeve për bashkinë dhe pjesë e këtij materiali është edhe hartëzimi i pikave të grumbullimit. Aktualisht, bashkia punon mbi një material të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Në rregullore përfshihen edhe pikat që ju sapo diskutuat, si hedhja e mbetjeve sipas qeseve përkatëse dhe ndarja e tyre sipas kategorive.

Gjithashtu, kemi vendosur kosha të rinj në pjesën më të madhe të qytetit, aty ku koshat ekzistues kanë qenë në gjendje jo të mirë. Megjithatë, sfida më e madhe mbetet ndërgjegjësimi i qytetarit. Pjesa e përdorimit të kamionçinave për bizneset është ende në diskutim dhe po shqyrtohet mundësia që ky shërbim të ofrohet kundrejt një tarife, pasi ka kosto shtesë për bashkinë.

Ndërkohë, në vitin 2025 është miratuar edhe ligji për prodhuesit e mëdhenj të mbetjeve. Aktualisht po diskutohen aktet nënligjore për zbatimin e tij, ku parashikohet që bizneset të lidhin kontrata me operatorë privatë për menaxhimin e mbetjeve të riciklueshme, si plastika dhe kartoni.



Qytetare: Ku duhet të grumbullohen mobiljet e vjetra dhe sendet që nuk shërbejnë më? A keni menduar për një vend të posaçëm grumbullimi për këto mbetje?

Drejtores e Ndërmarrjes së Pastrimit – znj. Anjeza Shiko: Në buxhetin shtesë që bëmë për rishikimin e buxhetit të bashkisë, kemi kërkuar edhe shtimin e një mjeti me kontenierë metalikë të mëdhenj, të cilët do të shërbejnë vetëm për grumbullimin e mbetjeve jo urbane, si mbetjet elektroshtepiake apo mbetjet e gjelbra.

Për këtë, në materialin e paraqitur kemi lënë një paragraf ku përcaktohet se grafiku i hedhjes së këtyre mbetjeve do të jetë në varësi të Ndërmarrjes së Pastrimit, duke parë nevojat e qytetit. Në hapin e parë është menduar të blihen 10 kontenierë të tillë, duke vendosur një grafik sipas rajoneve, 2 ditë në javë për çdo rajon, në mënyrë që të arrihet një normalizim i situatës.

Nënkryetare e Bashkisë – znj. Irena Toshkallari: Po për bizneset e Lungomares, si do të funksionojë ky proces?

Drejtores e Ndërmarrjes së Pastrimit – znj. Anjeza Shiko: Dua të shtoj diçka në lidhje me shërbimin e pastrimit që ofron Agjencia Kombëtare e Bregdetit. Në fashën orare nga ora 18:00 deri në 06:00 të mëngjesit, bashkia ka menduar që ky shërbim të kryhet nga operatori që do të lidhë kontratën me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, vetëm për t'u shërbyer bizneseve të Lungomares.

Harta e kësaj kontrate shtrihet nga Akërnja deri në Orikum, në zonën e Pashalimanit, duke ofruar një shërbim të shtuar për heqjen e mbetjeve përgjatë bizneseve në këtë vijë bregdetare.

Anëtar i Këshillit Bashkiak - z. Gjergj Nika: Të gjitha sugjerimet që janë bërë të merren në konsideratë dhe të aplikohen, në mënyrë që këto fashat e orareve të funksionojnë sa më mirë.

Drejtores e Ndërmarrjes së Pastrimit – znj. Anjeza Shiko: Propozimet që kemi sjellë janë konsultuar edhe me bizneset.

Nënkryetar i Këshillit Bashkiak Vlorë-z. Novruz Rrokaj: E vlerësoj këtë dëgjese publike për vendosjen e kësaj fashe orare, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së pastërtisë në qytet. Mendoj se përgjegjësia për pastërtinë nuk është vetëm e bashkisë, por edhe e ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit të qytetarëve.

Faleminderit!

Koordinatorë për Njoftim dhe Konsultim Publik

Aurora Kamberaj